



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE**

Nr. 1710/1 prot.

Tiranë më 13.11.2018

Lënda: Mendim mbi projekt marrëveshjen "Për njohjen reciproke të patentë shoferëve"

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.13474/2 Prot., datë 12.11.2018, projekt marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë "Për njohjen reciproke të patentë shoferëve", vlerësohet e hartuar konform ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Ndërkohë, për ta bërë më të plotë projekt marrëveshjen, në këndvështrimin e mbrojtjes së të dhënave personale, sugjerojmë:

Pas pikës 1, të nenit 10, të shtohen dy pika me këtë përmbajtje:

"Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese duhet të informojnë subjektet e të dhënave personale lidhur me transferimin ndërkombëtar të të dhënave në përputhje me legjislacionin kombëtar respektiv të mbrojtjes së të dhënave."

"Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese duhet të njoftojnë institucionet kombëtare të mbrojtjes së të dhënave personale mbi transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale në përputhje me legjislacionin kombëtar respektiv të mbrojtjes së të dhënave".

Pas pikës 6, të nenit 10, të shtohet një pikë me këtë përmbajtje :

"Palët kontraktuese që vihen në dijeni me të dhënat personale për qëllim të kësaj marrëveshje detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të saj".

Në referencë për sa më lart, pika e parë e sugjeruar nga ana jonë dhe parashikuar në nenin 18, të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar konsiston në detyrimin për informim të kontrolluesit i cili do të transferojë të dhënat personale. Në praktikë, informimi duhet të kryhet përpara transferimit ndërkombëtar të të dhënave

personale dhe një mënyrë informimi mund të jetë edhe publikimi i këtij informimi nëpërmjet faqes zyrtar të kontrolluesit.

Në lidhje me pikën e dytë të sugjeruar nga ana jonë, detyrimi për përditësim e njoftimit, rrjedh nga neni 21, i ligjit nr.9887/2008, sipas të cilit për çdo përpunim dhe qëllim të ri, duhet të njoftohet Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Sa i përket pikës së tretë të sugjeruar, referuar nenit 28, të nr.9887/2008, çdo kontrollues i cili përpunon të dhëna personale ka detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

